

VENDIM
Nr. 1055, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR INSTRUMENTET MATËSE”, NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1351, DATË 3.10.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE
METROLOGJIKE, PËR INSTRUMENTET MATËSE, LIGJËRISHT TË
KONTROLLUARA”, DHE PËRCAKTIMIN E LISTËSSË STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 dhe 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, dhe pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.

2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të instrumenteve, referuar në pikën 1, sipas listës bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.

3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të instrumenteve, referuar në pikën 1, me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik të këtij vendimi.

4. Në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pjesën II, “Matësit materialë të gjatësisë”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime”, “Kërkesa teknike metrologjike” dhe “Vendosja në treg”;

b) Në pjesën III, “Masat e kapacitetit të shërbimit dhe masat vëllimore”, shfuqizohen dispozitat për masat e kapacitetit të shërbimit;

c) Në pjesën IV, “Kontatorët e taksive (Taksimetrat)”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime dhe përcaktime”, “Kërkesa teknike-metrologjike”, “Kërkesa të tjera” dhe “Vendosja në treg”;

ç) Në pjesën V, “Sistemet e matjes së sasive të lëngjeve, përveç ujit”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime-përcaktime”, “Kërkesat teknike- metrologjike”, dhe “Vendosja në treg”.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama